

# Shënime për pasqyrat financiare

## Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

### (Të gjitha balancat janë në lekë).

(Të gjitha balancat janë në lekë).

---

#### 1. Informacione te pergjitheshme

"ALTO" sh.p.k, është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 08.11.2017. Kapitali regjistruar është 14.150.000 lek dhe zotërohet nga ortakët themelues, Shoqëria Sigal Bussines Center dhe z. Adrian Totokoci respektivisht 80 % dhe 20 %.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërise për ushtrimin 2020 janë shërbimet importim, tregtimi dhe riparimi i automjeteve.

#### 2. Permbledhje e politikave kontabel

##### Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

##### Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

##### Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tjerëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.

##### Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 janë  
1 euro=123.7lek dhe 1 dollar= 100.84 lek

##### Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2020 është 15 %.

### Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuara. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e vlerës mbetur për të gjitha aktivet e qëndrueshme materiale të shoqërisë.

### Gjendjet e inventarëve

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

### 3. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në bankë dhe arke, në lekë dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarisë	Monedha	Gjendja në 31.12.2020		Gjendja në 31.12.2019	
		Në lekë	Në valute	Në lekë	Në valute
Llogari bankare	LEK	13,897,388	-	26,093,081	-
Arka në lekë	LEK	112,715	-	-	-
<b>Shuma</b>		<b>14,010,103</b>	<b>x</b>	<b>26,093,081</b>	<b>x</b>

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizike të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të Bankës së Shqipërisë.

### 4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kërkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2020 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
<b>Aktive të tjera financiare afatshkurtra</b>		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	27,157,586	25,773,754
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme Shteti tatim taksa		
(iii) Instrumente të tjera borxhi		
(iv) Investime të tjera financiare		
(v) Te tjera tvsh	4,690,761	
<b>Shuma</b>	<b>31,848,347</b>	<b>25,773,754</b>

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " jane pasqyruar faturat e papaguara per shitjet qe shoqeria ka realizuar gjate ushtrimit si edhe furnitori Toyota Balkan per paradhenien.

## 5. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
<b>Inventari</b>		
(i) Lëndët e para	-	-
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për rishitje	43,857,600	10,345,077
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
<b>Shuma</b>	<b>43,857,600</b>	<b>10,345,077</b>

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2020. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kosos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2020 eshte 202.424.041 lek.

Shuma e inventarit te paraqitur ne " mallra" perfaqeson stokun e mallrave gjendje ne magazine , per tu shitur ne periudhen ne vazhdim.

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kosos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

## 6. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Mjete Transporti	Aktivitet të tjera afatgjata materiale	Totali
Kosto e AAM-ve 31.12.2019	-	-	0	3,584,460	6,635,879	10,220,339
Shtesat	-	-	-	760,842	236,158	7,844,578
Pakesimet	-	-	0	-	-90,575	-90,575
Kosto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	11,192,880.00	6,781,462.00	17,974,342.00
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2019	-	-	-	238,963	2,086,961	2,325,924
Amortizimi ushtrimit	-	-	0	1,039,173	928,371	1,967,544
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-	0
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	1,278,136	3,015,332	4,293,468
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2019	-	-	-	-	-	10,220,339
Shtesat	-	-	-	-	-	7,844,578
Pakesimet	-	-	-	-	-	-90,575
Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	-	-	17,974,342
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	3,345,497	4,548,918	7,894,415
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	9,914,744	3,766,130	13,680,874

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2020 si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston. Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane te njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

## 7. Aktive të tjera financiare afatgjata

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare afatgjata , ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Huamarrjet		
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra	0	0
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata	0	0
(iii) Tituj të tjerë të huadhënies	8,237,000	8,217,700
Shuma	8,237,000	8,217,700

Shumat e paraqitura ne "Tituj te tjere te huadhenies" paraqesin garancine me vlere 1.237.000 Lek = 10.000 Euro per Toyota Balkan si dhe hua te dhena ortakeve ne masen 7.000.000 Lek

#### 8. Detyrime afatshkurtera-Huamarriet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
<b>Huamarriet</b>		
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra	0	0
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata	0	0
(iii) Bono të konvertueshme	0	0
(iv) Te ardhura te shtyra (488)	148,959	9,119,954
<b>Shuma</b>	<b>148,959</b>	<b>9,119,954</b>

Shitjet ne total te deklaruar ne Sistemim Tatimor jane 231.948.974 Lek. Shitjet ne pasqyren Te ardhura dhe Shpenzime nuk perputhen me shitjet sipas FDP – ve ne Sistemin tatimor pasi ne shitjet e periudhes 2020 jane shtuar te ardhurat me 9.119.954 Lek paradhenie te dhena ne vitin 2020 dhe jane pakesuar me 148.959 lek pasi jane paradhenie per periudhat e ardhshme. Diferenca prej 2.093 Lek eshte difference kursi.

#### 9. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
<b>Huatë dhe parapagimet</b>		
1. Detyrime ndaj institucionve te kreditit		
2. Të pagueshme ndaj furnitorëve		7,632,653
3. Të pagueshme ndaj punonjësve +sig.shoqerore	1,051,584	794,744
4. Detyrimet tatimore	1,606,887	3,107,605
5. Hua të tjera		
6. Te tjera detyrime shteti		
<b>Shuma</b>	<b>2,658,471</b>	<b>11,535,002</b>

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht. Detyrimet tatimore perfshijne per Tatim Fitimi – 1.609.343 Leke.

#### 10. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Hua afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020ane si meposhte:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Huamarrjet		
Titujt e huamarrjes		
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		
Arkëtimet në avancë për porosi		
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		
Dëftesa të pagueshme		
Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit		
Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesë:	0	0
Të tjera të pagueshme	77,963,375	43,518,318
<b>Shuma</b>	<b>77,963,375</b>	<b>43,518,318</b>

Te zeri shuma te tjera te pagueshme futet borxhi qe shoqeria i ka shoqerise AVEL Sh.p.k. ne daten 31.12.2020

## 11. Kapitallet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc me 31.12.2020 eshte 14.150.000 Lek , i ndare ne 1 kuote kuota me vlere nominale 14.150.00.000 Lek / kuota..

## 12. Fitimi (humbja) e vitit financiar

### ▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2019	31
<b>Te ardhurat nga shitja e produkteve</b>			0
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve	240,833,991	153,147,041	
Te ardhurat nga shitja e mallrave			
Te ardhura nga shitja e AQT	83,885	4,541,270	
Te ardhurat nga qeraja te tjera			
<b>Shuma</b>	<b>240,917,876</b>	<b>157,688,311</b>	

Shitjet ne total te deklaruar ne Sistemim Tatimor jane 231.948.974 Lek. Shitjet ne pasqyren Te ardhura dhe Shpenzime nuk perputhen me shitjet sipas FDP – ve ne Sistemim tatimor pasi ne shitjet e periudhes 2020 jane shtuar te ardhurat me 9.119.954 Lek paradhenie te dhena ne vitin 2020 dhe jane pakesuar me 148.959 lek pasi jane paradhenie per periudhat e ardhshme. Diferenca prej 2.093 Lek eshte diference kursi.

### ▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2020 jane treguar ne pasqyren perkatese.

### ▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)		0
Shpenzimet per interesat 767, 668(-)		
Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)	958,318.00	482,429.00
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	(210,761)	(252,947)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	3,779,646.00	3,559,215.00
	<b>4,527,203</b>	<b>3,788,697</b>

#### ▪ Shpenzime personeli

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

Pagat e personelit arrijne ne shumen 6.708.464 lek si dhe kontributi i sigurimeve shoqerore dhe shendetesore i punedhenesit shumen 844.675 lek .

### 13. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2020 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	19,860,232	10,580,196
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	1,141,903	1,316,739
1 Amortizime te normave fiskale		
2 Shpenzime pritje e dhurime te kufirit tatimor		
3 Gjoha, penalitete, demshperblime		
4 Provizione qe nuk njihen		
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	1,141,903	1,316,739
6 Te tjera		
III PJESA E HUMBYES SE MBARTUR(-)		
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	21,002,135	11,896,935
V Shpenzimi i tatim fitimit-15%	3,150,324.00	1,784,540
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	16,709,909	8,795,656

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

### 14. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

ADMINISTRATORI

ADRIAN TOTOKOCI  
**ALTO S.p.k.**  
 Autostrada Tiranë - Durrës Km 5  
 Rruga Monun 58, Fshati Kashar  
 1051 Tiranë  
 NIPT: L72308027D  
 Tel: 048200703